VI. Procedura specifike për akordimin e grantit të bazuar në performancë

1. Granti i bazuar në performancë, për vitin 2025 ka burim financimi:

a) të brendshëm, në shumën 200 milionë lekë, si zë i veçantë i fondit të akorduar për buxhetin vendor si transfertë e pakushtëzuar sektoriale;

b) të huaj, në shumën 260 milionë lekë nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA).

A. Procedurat për akordimin e fondeve me burim financimi të brendshëm të grantit të bazuar në performancë të bashkitë përfituese

1. Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve pas marrjes së vendimit për bashkitë fituese njofton Ministrinë e Financave duke përcaktuar shumën përkatëse që përfiton çdo bashki për vitin 2025.

2. Ministria e Financave shpërndan fondin të bashkitë përfituese pas marrjes së njoftimit për vendimin e marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve.

3. Granti i performancës në vitin 2025 do të shpërndahet në bashkitë përfituese në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale.

4. Bashkitë kanë pavarësi të plotë të destinacionit të përdorimit të këtij fondi, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblime.

5. Fondet e papërdorura nga granti i performancës së përfituar nga bashkitë në vitin 2025 me burim financimi transfertën e pakushtëzuar sektoriale, trashëgohen në vitin 2026 për t'u përdorur për të njëjtin destinacion/qëllim.

B. Procedurat për akordimin e fondeve me burim financimi të huaj të grantit të bazuar në performancë të bashkitë përfituese

1. Fondet e financimit të huaj për grantin e bazuar në performancë përfitohen në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, mbi bazën e marrëveshjes përkatëse midis Qeverisë së Zvicrës dhe asaj Shqiptare sipas ligjit nr. 114/2024, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin "Bashki të forta (BTF), faza 2", dhe menaxhohen bazuar në udhëzimin nr. 10, datë 12.7.2024, "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", sipas skemës me thesar të plotë.

2. Disbursimi dhe ekzekutimi i fondeve të grantit të bazuar në performancë bëhet nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit (TSA) në Bankën e Shqipërisë (BSH).

3. Për të transferuar fondet nga donatori në TSA në mbështetje të marrëveshjes të miratuar me ligjin nr. 114/2024 të sipërcituar, struktura e përcaktuar për të menaxhuar fondet e financimit të huaj për grantin e bazuar në performancë në ministrinë përgjegjëse për financat, i dërgon zyrtarisht (me firmë të nëpunësit/nëpunëses të parë autorizues) donatorit (Ambasadës Zvicerane/SDC) formularin e identifikimit financiar (FIF), të plotësuar sipas formatit në aneksin nr. 2 të udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024, "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare".

4. Formulari i identifikimit financiar përveç referencave të TSA, në fushën REMARK përmban edhe kodin e produktit me emërtimin "Grant performance për bashkitë", i cili çelet nga struktura përgjegjëse për Thesarin në qendër me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.

5. SDC/Ambasada Zvicerane pasi merr formularin e identifikimit financiar të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për financat sipas pikës 3 më sipër, kryen disbursimin e financimit të huaj (në euro) duke vendosur në përshkrimin e transfertës bankare të dhënat e fushës REMARK të FIF.

6. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër krediton llogarinë ekonomike "106xxxx" pa specifikuar institucionin dhe ministrinë e linjës, bazuar në njoftimin e Bankës së Shqipërisë.

7. Akordimi i grantit të bazuar në performancë të bashkitë, mbështetet në vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Grantit të Bazuar në Performancë, vendim i cili në momentin e përzgjedhjes së bashkive përfituese i dërgohet zyrtarisht Ministrisë së Financave dhe bashkive nga AMVV-ja.

8. Bashkitë fituese pasi janë informuar për vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve bëjnë me dije Këshillin Bashkiak (KB), i cili, në përputhje të plotë me përcaktimet e ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, merr vendimin për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të këtij fondi.

9. Pas marrjes së vendimit nga KB-ja, bashkitë i dërgojnë ministrisë përgjegjëse për financat vendimin e KB për përcaktimin e destinacionit/qëllimit të përdorimit të këtij fondi, duke kërkuar çeljen e kodit të produktit/projektit për të cilin do përdoret ky fond.

10. Bashkitë kanë pavarësi të plotë të destinacionit të përdorimit të këtij fondi, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblime.

11. Ministria e Financave, pas marrjes së vendimit të KB-së dhe kërkesës për çelje kodi bëjnë të mundur çeljen e kodit të produktit/projektit në SIFQ me qëllim më pas transferimin e fondit duke debituar kod institucioni 0000000, ministri linje 00, llogari ekonomike 106xxxx dhe kredituar kod institucioni kodin e bashkisë përkatëse, kod ministrie linje 00, dhe kodin përkatës të produktit/projektit bazuar në kërkesën e bashkive përkatëse.

12. Alokimi i fondeve për shpenzim bëhet me kapitull 02 “Financimi i huaj”.

13. Fondi i pashpërndare në TSA gjatë vitit buxhetor, shpërndahet në vitin buxhetor pasardhës për të njëjtin qëllim, vetëm me vendim të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve.

14. Gjendja e fondit të prokuruar dhe të papërdorur nga bashkitë në fund të vitit buxhetor trashëgohet në vitin buxhetor pasardhës dhe përdoret për të njëjtat projekte/produkte për të cilin është prokuruar.

15. Gjendja e fondit të ngelur tepriçë nga procesi i prokurimit përdoret nga bashkitë për qëllime të tjera që ato gjykojnë dhe vendosin me vendim të këshillit bashkiak.

VII. Monitorimi, raportimi dhe auditimi i grantit të bazuar në performancë

1. Bashkitë mbajnë dhe ruajnë evidencë të plotë të përdorimit të grantit me burim financimi buxhetin e shtetit dhe nga donatorët, dhe raportojnë pranë Ministrisë së Financave mbi progresin e projekteve.

2. Ministria e Financave, bazuar në raportimet e bashkive publikon përdorimin e fondeve të GBP-së. Raportet u dërgohen donatorëve nga Ministria e Financave.

3. Të gjitha fondet e financuara përmes GBP-së i nënshtrohen auditimit sipas legjislacionit në fuqi. Auditimi realizohet nga institucione të pavarura të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

4. Donatorët kanë të drejtë të kryejnë monitorime në terren dhe të kërkojnë me shkrim auditimin e përdorimit të fondeve grant të dhëna sipas këtij udhëzimi, për raste të veçanta, kur shuma e grantit është më e madhe se 4 milionë lekë, e përdorur në një projekt të vetëm. Në këto raste, auditimi mund të kryhet nga subjekte të angazhuara posaçërisht nga donatorët e grantit dhe shpenzimet e auditimit në këto raste mbulohen nga donatorët.

VIII. Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe bashkitë për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Institucionet e përfshira në KVA të parashikuara sipas pikës 3 të kreut V të këtij udhëzimi dhe aneksit 3, të dërgojnë me shkresë zyrtare pranë AMVV-së emrat e përfaqësuesve/përfaqësuesve të tyre brenda 5 ditëve pune nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

3. Pjesë integrale e këtij udhëzimi janë anekset, bashkëlidhur si më poshtë:

Aneksi 1: “Afatet kohore për procedurën e aplikimit, shpërndarjes dhe përdorimit të GBP-së”;

Aneksi 2: “Vlerësimi nga AMVV-ja i dokumentacionit të paraqitur nga bashkitë”;

Aneksi 3: “Vlerësimi nga KVA-ja i cilësisë së planeve të paraqitura nga bashkitë dhe treguesve financiarë të performancës”;

Aneksi 4: “Përlllogaritja e shumave që përfitojnë bashkitë”.

4. Shpërndarja e GBP-së për vitin pasardhës do të rregullohet me dispozita shtesë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

MINISTËR I SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR
Arbjan Mazniku

ANEKSI 1 AFATET KOHORE PËR PROCEDURËN E APLIKIMIT, SHPËRNDARJES DHE PËRDORIMIT TË GBP-së

- Periudha e përgatitjes për aplikime nga bashkitë: deri më 17 shtator 2025

- Ofrimi i mbështetjes për bashkitë (trajnim, shembuj): deri më 17 shtator 2025
- Vlerësimi i aplikimeve: shtator 2025
- Miratimi i bashkive fituese: shtator–tetor 2025
- Alokimi i fondeve: tetor–nëntor 2025
- Përfshirja në buxhetin vendor: tetor–nëntor 2025
- Monitorim dhe raportim: fillon nga dhjetor 2025

ANEKSI 2

VLERËSIMI NGA AMVV-ja I DOKUMENTACIONIT TË PARAQITUR NGA BASHKITË

- AMVV-ja verifikon dokumentacionin e paraqitur nga bashkitë, duke kontrolluar saktësinë e tyre dhe të dhënave që përmban.

- Për GBP-të e vitit **2025**, treguesit quhen të plotësuar nëse përputhen me afatet si më poshtë:

1. Një Plan Mbarështimi Pyjesh i miratuar nga **MTM-ja në periudhën 1 janar – 17 shtator 2025**. Për këtë tregues do të merret parasysh edhe vetëm një ekonomi pyjore.

2. Një Plan Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve i miratuar nga **Këshilli Bashkiak përkatës** sipas legjislacionit në fuqi, në periudhën **1 janar 2025 – 17 shtator 2025**.

3. Një Plan Social Vendor i miratuar nga **Këshilli Bashkiak përkatës** në periudhën **1 janar - 17 shtator 2025**.

4. Një Plan Vendor i Arsimit Parauniversitar i miratuar nga **Këshilli Bashkiak përkatës** në periudhën **1 janar – 17 shtator 2025**.

5. Një Plan Vendor i Integritetit i miratuar nga **Këshilli Bashkiak përkatës** në periudhën **1 janar – 17 shtator 2025**.

6. Një Plan Vendor i Barazisë Gjinore i miratuar nga **Këshilli Bashkiak përkatës** në periudhën **1 janar – 17 shtator 2025**.

7. Bashkia ka raportuar treguesit e matjes së performancës për vitin e referencës 2024 në përputhje me kërkesat e paraqitura në këtë udhëzim, të ndara në tre nëntregues: (i) bashkia ka raportuar treguesit brenda muajit korrik 2025; (ii) bashkia ka raportuar të gjithë treguesit e matjes së performancës; (iii) i gjithë stafi i Njësisë së Performancës në Bashki ka ndjekur trajnimet për treguesit e matjes së performancës.

8. **Niveli i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura** me të paktën 30%, në periudhën referuese nga **31.12.2024 deri 30.6.2025**.

9. **Realizimi i Planit të Buxhetit** të Bashkisë, realizimi faktik të buxhetit në **6-mujorin e parë** të vitit 2025 ndaj planit vjetor për vitin 2025 **jo më pak se 35%**.

10. **Niveli i realizimit të të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme** më shumë se **20%**, kundrejt vitit paraardhës.

- Dokumentacioni që duhet të paraqitet nga secila Bashki, për secilin tregues për GBP për vitin 2025, si dhe verifikimi që bën AMVV, është sipas tabelës vijuese:

Nr.	Treguesi i GBP-së	Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga Bashkia	Verifikimi që bën AMVV
1	Një Plan Mbarështimi Pyjesh i miratuar nga MTM-ja në periudhën 1 janar - 17 shtator 2025 . (Për këtë tregues do të merret parasysh edhe vetëm një ekonomi pyjore).	Plani i Mbarështimit të Pyjeve për ekonominë pyjore të përzgjedhur nga bashkia përkatëse Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve, për ekonominë pyjore të përzgjedhur nga bashkia përkatëse	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse Vendimi i Këshillit Bashkiak ka numrin e vendimit, datën e vendimit, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit bashkiak dhe nga sekretari i këshillit

			bashkiak, është i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
		Urdhri i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit që miraton Planin e Mbarështimit të Pyjeve për ekonominë pyjore të përzgjedhur nga bashkia përkatëse	Urdhri përmban numrin e regjistrimit, datën e urdhrit e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, tregon miratimin e planit për ekonominë përkatëse pyjore.
1.	Një Plan Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën <u>1 janar – 17 shtator 2025.</u>	Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse
		Vendimi i Këshillit të Qarkut për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve për bashkinë përkatëse. Lidhja e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse.	Vendimi i Këshillit të Qarkut ka numrin e vendimit, datën e vendimit e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit të qarkut dhe nga sekretari i këshillit të qarkut, është i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
		Akti i konfirmimit të VKQ nga Prefekti	Akti konfirmon VKQ përkatëse
2.	Një Plan Social Vendor i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën <u>1 janar - 17 shtator 2025.</u>	Plan Social Vendor	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Social Vendor për bashkinë përkatëse. Lidhja e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse	Vendimi i Këshillit Bashkiak ka numrin e vendimit, datën e vendimit e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit bashkiak dhe nga sekretari i këshillit bashkiak, është i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
		Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi	Procesverbali të jetë i nënshkruar sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme të këshillit bashkiak.
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti	Akti konfirmon VKB përkatëse
3.	Një Plan Vendor i Arsimit Parauniversitar i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën <u>1 janar 2025 - 17 shtator 2025.</u>	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar.	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar për bashkinë përkatëse Lidhja e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse.	Vendimi i Këshillit Bashkiak ka numrin e vendimit, datën e vendimit e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit bashkiak dhe nga sekretari i këshillit bashkiak, është i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
		Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi	Procesverbali të jetë i nënshkruar sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme të këshillit bashkiak.
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti	Akti konfirmon VKB përkatëse
4.	Një Plan Vendor i Integritetit i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën <u>1 janar 2025 - 17 shtator 2025</u>	Plani Vendor i Integritetit	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor të Integritetit për bashkinë përkatëse. Lidhja e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse	Vendimi i Këshillit Bashkiak ka numrin e vendimit, datën e vendimit e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit bashkiak dhe nga sekretari i këshillit bashkiak, është i publikuar në faqen

			zyrtare të bashkisë.
		Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi	Procesverbali të jetë i nënshkruar sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme të këshillit bashkiak
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti	Akti konfirmon VKB përkatëse
5.	Një Plan Vendor i Barazisë Gjinore i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 1 janar 2025 - 17 shtator 2025	Plani Vendor i Barazisë Gjinore.	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor të Barazisë Gjinore për bashkinë përkatëse. Lidhja e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse.	Vendimi i Këshillit Bashkiak ka numrin e vendimit, datën e vendimit e cila duhet të jetë brenda periudhës referuese, është i nënshkruar nga Kryetari i këshillit bashkiak dhe nga sekretari i këshillit bashkiak, është i publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.
		Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në të cilën është miratuar vendimi.	Procesverbali të jetë i nënshkruar sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme të këshillit bashkiak.
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti.	Akti konfirmon VKB përkatëse.
6.	Bashkia ka raportuar të treguesit e matjes së performancës për vitin e referencës 2024, të ndara në tre nëntregues: (i) Bashkia ka raportuar treguesit e matjes së performancës brenda afatit të përcaktuar; (ii) Bashkia ka raportuar të dhëna për të gjithë treguesit e matjes së performancës; (iii) I gjithë stafi i NJP-së i Bashkisë ka ndjekur trajnimet e treguesve të matjes së performancës të ofruara nga AMVV-ja.	Raportimi i të dhënave për treguesit e matjes së performancës për vitin 2025.	AMVV-ja verifikon që të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë brenda afatit të përcaktuar në udhëzimet për ushtrimin e matjes së treguesve të performancës.
		Lista e plotë e stafit të Njësisë së Performancës.	AMVV-ja verifikon që të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë për të gjithë treguesit
			AMVV-ja verifikon emrat e stafit përkundrejt listëpranisë në trajnime.
7.	Bashkia ka shlyer detyrimet e prapambetura me të paktën 30%, në periudhën referuese, nga data 31.12.2024 deri në datën 30.6.2025.	Raporti i detyrimeve të prapambetura gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë.	AMVV-ja verifikon informacionin e dërguar nga Ministria e Financave. Bashkitë të cilat nuk kanë detyrime të prapambetura vlerësohen me të gjitha pikët për këtë tregues.
8.	Bashkia ka realizim faktik të buxhetit në 6-mujorin e parë 2025 ndaj planit vjetor për vitin 2025 jo më pak se 35%.	Raporti i të dhënave për planin dhe faktin e realizimit të buxhetit të bashkive, për periudhën referuese, gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë.	AMVV-ja verifikon informacionin e dërguar nga Ministria e Financave.
9.	Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me 20% në 6-mujorin e parë të 2025-s ndaj së njëjtës periudhë të 2024. Në këtë vlerësim nuk përfshihet taksa e	Raportimi i të dhënave nga bashkitë për realizimin e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme. Raporti i Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë.	DPTP-ja, pas verifikimit dhe analizimit të të dhënave të dërguara nga bashkitë dhe në përputhje me raportin e gjeneruar nga SIFQ-ja dërgon informacionin tek AMVV-ja.

	transaksioneve mbi pasurinë e paluajtshme.		
--	--	--	--

ANEKSI 3
VLERËSIMI NGA KVA-ja I CILËSISË SË PLANEVE TË PARAQITURA NGA BASHKITË DHE TREGUESVE FINANCIARË TË PERFORMANCËS

- KVA-ja vlerëson planet vendore e treguesit e tjerë të paraqitura nga bashkitë, dhe verifikon se:

- Dokumentacioni i paraqitur iu referohet treguesve të GBP-së;
- Planet e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara të cilësisë;
- Mosplotësimi i qoftë edhe njërit prej kriterëve të cilësisë, tregon që kriteri i performancës (Plani) të konsiderohet jo i përmbushur.

- KVA-ja përbëhet nga:

- një anëtar/anëtare nga ministria përgjegjëse për pushtetin vendor;
- një anëtar/anëtare nga ministria e financave;
- një anëtar/anëtare nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë.

Dhe për secilin plan:

- dy anëtarë/anëtare nga ministria përgjegjëse për pyjet dhe për menaxhimin e mbetjeve;
- dy anëtarë/anëtare nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- dy anëtarë/anëtare nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- dy anëtarë/anëtare nga ministria përgjegjëse për administratën dhe antikorrupsionin.
- kriteret e cilësisë për secilin tregues janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Treguesi i performancës i GBP	Kriteret e cilësisë së planeve
1	Plani i Mbarëshimit të Pyjeve	Në përputhje me udhëzimet\kërkesat e MTM
2	Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	Planet në fushën e menaxhimit të mbetjeve i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor, referuar nenit 2 të ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor", të ndryshuar. Plani parashikon përqindjen e mbulimit të kostos nga tarifa Plani parashikon përqindjen e mbulimit me shërbim të (i) territorit, dhe/ose (ii) popullsisë Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit. Plani përmban një mekanizëm monitorimi Plani mbulon një periudhë 5-vjeçare
3	Plani Social	Plani përmban analizën e nevojave për shërbime sociale bazuar në: a) numrin e popullsisë; b) shkallën e papunësisë; c) numrin e përfituesve të Ndihmës Ekonomike; d) numrin e personave me aftësi të kufizuara; e) numrin e shërbimeve sociale të ofruara; të ndara sipas tipologjisë së shërbimeve; f) numri i përfituesve për çdo shërbim të ndara sipas gjinisë. Plani shpreh zgjerimin e hartës së shërbimeve, që ofron bashkia, me të paktën 1 shërbim për bashkitë me popullsi nën 10000 banorë, 4 shërbime për bashkitë me popullsi nga 10000-50000 banorë dhe 10 shërbime për bashkitë me popullsi mbi 50000 banorë. Plani përmban kalendarin e aktiviteteve për çdo vit, si dhe financimin e aktivitetit/shërbimit që specifikon burimin që mbështet (buxheti i bashkisë/buxheti kombëtar/donatorë). Plani përmban metodologjinë e monitorimit dhe njësinë e ngarkuar me monitorimin e zbatimit të aktivitetit dhe treguesit e matjes së performancës

		së shërbimeve të kujdesit shoqëror. Plani mbulon një periudhë të paktën 3-vjeçare
4	Plani i arsimit parauniversitar	Përmban një plan masash për rritjen e pjesëmarrjes dhe sigurimin e gjithëpërfshirjes në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Plani përmban analizën dhe shpërndarjen e infrastrukturës arsimore në territorin e bashkisë Plani përmban analizën dhe shpërndarjen e stafit arsimor në territorin e bashkisë Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit. Plani përmban një mekanizëm monitorimi Plani duhet të mbulojë një periudhë të paktën 3-vjeçare
5	Plani i Integritetit	Plani është në përputhje me Strategjinë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit 2024-2030 Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit. Plani përmban një mekanizëm monitorimi Plani duhet të mbulojë një periudhë të paktën 3 vjeçare
6	Plani i barazisë gjinore	Plani të përmbajë të paktën një paketë emergjence për viktimat e dhunës me masat dhe buxhetin e nevojshëm. Plani të përmbajë masa dhe veprime që parashikohen bazuar në SKBGJ 2021-2030. Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit. Plani përmban një mekanizëm monitorimi Plani duhet të mbulojë një periudhë të paktën 3-vjeçare
7	Treguesit e matjes së performancës	Të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë brenda afatit të përcaktuara në këtë udhëzim. Të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë për të gjithë treguesit e e matjes së performancës. Gjithë stafi i NJP-së i Bashkisë ka ndjekur trajnimet e treguesve të performancës.
8	Bashkia ka shlyer detyrimet e prapambetura me të paktën 30 %, në periudhën referuese	Niveli i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në periudhën e vlerësimit kundrejt periudhës referuese është mbi 30%.
9	Bashkia ka realizim faktik të buxhetit në 6-mujorin e parë 2025 ndaj planit vjetor për vitin 2025 jo më pak se 35%.	Realizimi i buxhetit për periudhën referuese kundrejt planit vjetor të buxhetit është në nivelin mbi 35%.
10	Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me 20%.	Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me 20% në 6-mujorin e parë të 2025-s ndaj së njëjtës periudhë të 2024. Në këtë vlerësim nuk përfshihet taksa e transaksioneve mbi pasurinë e paluajtshme.

ANEKS 4 PËRLLOGARITJA E SHUMAVE QË PËRFITOJNË BASHKITË

- Fondi i GBP-së shpërndahet për çdo bashki sipas një sistem matjeje të performancës që vlerëson përmbushjen e treguesve të vendosur.
- Bashkive që përmbushin treguesit e GBP-së në vitin 2025 do t'u shpërndahet:
- Një shumë që është proporcionale me peshën e caktuar për secilin tregues, si më poshtë:
- Një fond shtesë që përllogaritet proporcionalisht në bazë të fondeve të mbetura dhe treguesve të përmbushur.
- Shumat fikse për vitin 2025 janë sipas tabelës së mëposhtme.

Nr.	Treguesit e performancës 2025	Pesha e treguesit të matur	Shumat (në lekë) referuese për treguesit për 61 bashki	Shumat (në lekë) referuese për treguesit për 1 bashki
	Fondi GBP gjithësej	100%	460,000,000	7,540,984
1	Plani i Mbarështimit të Pyjeve	25%	115,000,000	1,885,246
2	Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	10%	46,000,000	754,098
3	Plani Social vendor	10%	46,000,000	754,098
4	Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar	10%	46,000,000	754,098
5	Plani Vendor për Barazinë gjinore	5%	23,000,000	377,049
6	Plani i Integritetit	5%	23,000,000	377,049
7.1	Treguesit e matjes së performancës raportuar në kohë	2%	9,200,000	150,820
7.2	Treguesit e matjes së performancës raportuar të gjithë treguesit	2%	9,200,000	150,820
7.3	Stafi i Njësive të Performancës i trajnuar	1%	4,600,000	75,410
8	Treguesi i detyrimeve të prapambetura	10%	46,000,000	754,098
9	Treguesi i realizimit të buxhetit	10%	46,000,000	754,098
10	Treguesi i taksës mbi pasurinë e paluajtshme	10%	46,000,000	754,098

- Shpërndarja e fondit bëhet sipas dy komponentëve: (i) shuma fikse; (ii) shuma shtesë.
- Duke marrë një **shembull hipotetik** të plotësimit të treguesve nga bashkitë, shpërndarja është:
- **Supozojmë** se në thirrjen e GBP-së për vitin 2025 marrin pjesë 61 bashki. Pas vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar, dhe nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit të treguesve të performancës, përllogaritja e shumave të shpërndara është më poshtë:
- **Shuma fikse** e përcaktuar për secilin tregues për vitin 2025 shpërndahet sipas tabelës vijuese

Bashki pjesëmarrëse	TP 1	TP 2	TP 3	TP 4	TP 5	TP 6	TP 7	TP 8	TP 9	TP 10	Total Fonde / shuma proporcionale me TP
bashkia 1	1,885,246	754,098	754,098	754,098	377,049	377,049	377,049	754,098	754,098	754,098	7,540,984
bashkia 2		754,098	754,098		377,049	377,049	377,049	754,098	754,098	754,098	4,901,639
bashkia 3	1,885,246		754,098			377,049	377,049		754,098		4,524,590
bashkia 4		754,098					377,049	754,098		754,098	3,393,443
bashkia 5						377,049	377,049				754,098
bashkia 6	1,885,246	754,098		754,098					754,098		4,901,639
bashkia 7					377,049		377,049			754,098	1,885,246
bashkia 8		754,098	754,098				377,049		754,098		3,816,393
bashkia 9	1,885,246		754,098			377,049	377,049		754,098	754,098	4,901,639
bashkia 10	1,885,246	754,098	754,098	754,098				754,098			5,655,738
bashkia 11						377,049	377,049		754,098		1,588,197
bashkia 12							377,049			754,098	1,131,148
bashkia 13	1,885,246	754,098	754,098	754,098	377,049	377,049	377,049		754,098		6,832,787
bashkia 14		754,098	754,098			377,049	377,049	754,098			3,816,393
bashkia 15	1,885,246			754,098	377,049	377,049	377,049		754,098	754,098	5,278,689
bashkia 16		754,098	754,098	754,098		377,049	377,049	754,098	754,098		4,524,590
bashkia 17			754,098			377,049			754,098		2,262,295
bashkia 18				754,098		377,049	377,049	754,098	754,098	754,098	3,770,492
bashkia 19		754,098	754,098		377,049	377,049	377,049	754,098	754,098	754,098	4,147,541
bashkia 20	1,885,246				377,049	377,049	377,049		754,098		3,770,492
bashkia 21			754,098	754,098						754,098	3,770,492
bashkia 22				754,098		377,049	377,049		754,098		2,639,344
bashkia 23		754,098	754,098				377,049	754,098		754,098	3,770,492
bashkia 24	1,885,246	754,098	754,098		377,049	377,049	377,049		754,098	754,098	6,832,787
bashkia 25		754,098			377,049		377,049	754,098	754,098	754,098	4,147,541
bashkia 26			754,098	754,098		377,049	377,049		754,098	754,098	3,770,492
bashkia 27		754,098	754,098	754,098			377,049		754,098		3,770,492
bashkia 28	1,885,246	754,098			377,049		377,049				3,393,443
bashkia 29			754,098			377,049	377,049	754,098	754,098		3,393,443
bashkia 30		754,098		754,098		377,049	377,049	754,098	754,098	754,098	4,524,590
bashkia 31-61							11,688,524.59				11,688,525
Total fonde sipas kompj	18,852,459	12,065,574	12,819,672	9,049,180	5,655,738	8,672,131	23,000,000	9,803,279	17,344,262	10,557,377	127,819,672

Shuma shtesë shpërndahet mes të gjitha bashkive pjesëmarrëse për vitin 2025, në mënyrë të përpjeshtme me treguesit e përmbushur, por në asnjë rast jo më shumë se katërfishi i shumës fikse të përfutur. Shpërndarja e shumës shtesë për rastin hipotetik që kemi marrë do të jetë sipas tabelës vijuese.

Bashkitë	Shuma proporcionale shtesë	Bashkitë	Shuma për çdo bashki (shuma fikse + shtesa)
bashkia 1	19,597,659.46	bashkia 1	27,138,643
bashkia 2	12,738,478.65	bashkia 2	17,640,118
bashkia 3	11,758,595.68	bashkia 3	16,283,186
bashkia 4	8,818,946.76	bashkia 4	12,212,389
bashkia 5	1,959,765.95	bashkia 5	2,713,864
bashkia 6	12,738,478.65	bashkia 6	17,640,118
bashkia 7	4,899,414.87	bashkia 7	6,784,661
bashkia 8	7,839,063.78	bashkia 8	10,855,457
bashkia 9	12,738,478.65	bashkia 9	17,640,118
bashkia 10	14,698,244.60	bashkia 10	20,353,982
bashkia 11	3,919,531.89	bashkia 11	5,427,729
bashkia 12	2,939,648.92	bashkia 12	4,070,796
bashkia 13	15,678,127.57	bashkia 13	21,710,914
bashkia 14	7,839,063.78	bashkia 14	10,855,457
bashkia 15	13,718,361.62	bashkia 15	18,997,050
bashkia 16	11,758,595.68	bashkia 16	16,283,186
bashkia 17	5,879,297.84	bashkia 17	8,141,593
bashkia 18	9,798,829.73	bashkia 18	13,569,322
bashkia 19	10,778,712.70	bashkia 19	14,926,254
bashkia 20	9,798,829.73	bashkia 20	13,569,322

bashkia 21	9,798,829.73	bashkia 21	13,569,322
bashkia 22	6,859,180.81	bashkia 22	9,498,525
bashkia 23	9,798,829.73	bashkia 23	13,569,322
bashkia 24	15,678,127.57	bashkia 24	21,710,914
bashkia 25	10,778,712.70	bashkia 25	14,926,254
bashkia 26	9,798,829.73	bashkia 26	13,569,322
bashkia 27	9,798,829.73	bashkia 27	13,569,322
bashkia 28	8,818,946.76	bashkia 28	12,212,389
bashkia 29	8,818,946.76	bashkia 29	12,212,389
bashkia 30	11,758,595.68	bashkia 30	16,283,186
bashkia 31–61	30,376,372.16	bashkia 31–61	42,064,897
Total sipas komponentit 2	332,180,328	Total	460,000,000

GRANTI I BAZUAR NË PERFORMANCË 2025

Ndarja e Fondit për vitin 2025

		Pesha e treguesit të matur	Shumat (Lek) referuese për treguesit për 2025 [për 1 bashki]
Fondi GBP gjithsej (për 1 bashki)		100%	7,540,984
1	Plani i Mbarështimit të Pyjeve	25%	1,885,246
2	Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve 2025 - 2030	10%	754,098
3	Plani Social vendor 2024 - 2027	10%	754,098
4	Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar 2026 - 2028	10%	754,098
5	Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030	5%	377,049
6	Plani i Integritetit 2025 - 2028	5%	377,049
7.1	Të dhënat e SMP në kohë	2%	150,820
7.2	Të dhënat e SMP për të gjithë treguesit	2%	150,820
7.3	Stafi i NJVV-së i trajnuar	1%	75,410
8	Treguesi i detyrimeve të prapambetura	10%	754,098
9	Treguesi i realizimit të buxhetit	10%	754,098
10	Niveli i arkëtimit të të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	10%	754,098